



HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/168

Datë: 13.11.2024

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Nenit 162 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 14, të mbajtur më 13.11.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

- I. Miratohet kërkesa e Menaxhmentit për zgjatje të afatit kohor të përcaktuar në Vendimin Nr. I/128, të datës 29.08.2024 për zbatimin e sistemimit të të punësuarve sipas Skemës së re Organizative, Nr. I/127 të datës 29.08.2024 dhe Rregullores për Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës nr. I/30, të datës 29.08.2024, deri më datën 31.12.2024.
- II. Gjithashtu, edhe afati i fillimit të zbatimit të Aneksit 1 të Rregullores mbi Pagat dhe Kompensime Tjetra për Kategoritë dhe Nivelet e Pagave Nr. I/131, të datës 29.08.2024 zhvendoset nga data 01.10.2024 në datën 01.01.2025, ndërsa deri në këtë datë do të zbatohet Kategorizimi dhe Poentimi i Pagave Nr. II/86, të datës 22.12.2021.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Arsyetim

Marrë parasysh kërkesën e Menaxhmentit për zgjatje të afatit të zbatimit të sistemimit të të punësuarve sipas Skemës së re Organizative dhe vlerësimeve për punët e shumta në këtë proces, Bordi i Drejtorëve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues



Iu dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv
- Aksionarit – NJPMNP
- Departamentit të Administratës
- Arkivit